



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:029983

Datë: 11.12.2018

Numri i dokumentit: 00186553

**P. nr.450/2017**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **Diana Sina**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve A. K. dhe A. M. që të dytë nga Gjakova, shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje, nga neni 327 par.1 pika 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.808/2016 të datës 13.07.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **30.11.2018**, në prani të Prokurores së shtetit Mone Sylja, të akuzuarve, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datën **11.12.2018** këtë:

### A K T G J Y K I M

**1.I akuzuari A. K.**, nga i ati A. dhe e ëma L. e gjinisë M., data e lindjes . . . në fsh.Z. K.Gjakovë, e tani me banim në Gjakovë, Rr.... nr... ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

**2.I akuzuari A. M.**, nga i ati B. dhe e ëma T e gjinisë Z., data e lindjes në fshatin B. K.Gjakovë, e tani me banim në Gjakovë, në rrugën “...” nr..., ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

### J a n ë f a j t o r:

**Sepse:** Me datën 07.06.2016 rreth orës 03:00 të mëngjesit në Rr.”...” në Gjakovë me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim vjedhje, i marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit E. G. nga Gjakova, në atë mënyrë që duke përdorur forcën me anë të mjetit të fortë (levës) fillimisht këpusin drynin e derës së dyqanit D.P.”P.” pronë e të dëmtuarit, e depërtojnë brenda e vjedhin 10 pako cigare të llojit Malboro në vlerë prej 25 euro, 7 pako (cigare) të llojit Kent në vlerë prej 17 euro, 12 (dymbëdhjetë)copë pije Red Bull, në vlerë prej 18 euro, 10 (dhjetë)copë Coca Cola në vlerë prej 5 Euro, 12(dymbëdhjetë) copa çokolata Milka në vlerë prej 12 euro, 8(tetë) copë sallama të pulës në vlerë prej 8 euro, 9(nëntë) copë Kinder çokolata në vlerë prej 9 euro, si dhe para të gatshme në shumë prej 60 euro, e të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material në lartë prej 179 euro, e largohen në drejtim të paditur.

- me çka në bashkëkryerje ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë, nga neni 327 par.1 pika l lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,17 par.1,41,43,45,46,73, dhe nenit 327 par.1 pika l lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës.

## G J Y K O N

Të akuzuarin **A. K.** dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqind)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **12(Dymbëdhjetë)muajve**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë.

Të akuzuarin **A. M.** dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqind)Euro**, të cilën dënim është e detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **12(Dymbëdhjetë)muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **5(pesë) ditësh**, për secilin veç e veç, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës

I dëmtuari E. M. G. nga Gjakova, Rr.”....” nr...,kompensimin e dëmit mund ta realizon në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.808/2016, të datës 13.07.2017, kundër të akuzuarve A. K. dhe A. M. që të dytë nga Gjakova, shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje, nga neni 327 par.1 pika l e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjti të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

I akuzuari A. K. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaroi, se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën veprë jam penduar pa masë duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë të njëjtën, tani jam në vuajtje të dënimit për një veprë tjetër të ngjashme të kryer, vuajtja e dënimit ka ndikuar në rehabilitimin tim, prandaj premtoi se pas vuajtjes së dënimit do të kthehem jetës normale, do të filloj të punoj, të kontribuoj në familje, në kohën kur kam kryer këtë veprë kam qenë shumë i rij duke mos ditur pasojat e kryerjes së veprës, dhe se veprën e kam kryer së bashku me A. në momentin kur kemi deshtë që të konsumojmë pije freskuese dhe çokollata, shton se familja ime

është në gjendje të dobët materiale, andaj i propozoi gjykatës që të ketë parasysh rrethanat e lartë cekura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

I akuzuari A. M. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaroi, se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën veprë jam penduar pa masë, duke premtuar se të njëjtën nuk do ta përsërisë, veprën e kemi kryer duke marr një vendim të rastësishëm pa paramendim vetëm e vetëm që të konsumojmë pije freskuese dhe çokollata, duke mos i menduar pasojat e kryerjes së veprës, në atë kohë kam qenë shumë i rij, shton se unë jam i pa punë dhe familja ime është në gjendje të dobët materiale, unë herë pas herë punoi si punëtor fizik kur ka punë, dhe me të ardhurat e fituara ndihmoi familjen, andaj i propozoi gjykatës që të ketë parasysh rrethanat e lartë cekura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe të njëjtit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se të akuzuarit A. K. dhe A. M.: Me datën 07.06.2016 rreth orës 03:00 të mëngjesit në Rr."I. Q." në Gjakovë me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim vjedhje, i marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit E. G. nga Gjakova, në atë mënyrë që duke përdorur forcën me anë të mjetit të fortë (levës) fillimisht këpusin drynin e derës së dyqanit D.P."P." pronë e të dëmtuarit, e depërtojnë brenda e vjedhin 10 pako cigare të llojit Mariboro në vlerë prej 25 euro, 7 pako (cigare) të llojit Kent në vlerë prej 17 euro, 12 (dymbëdhjetë)copë pije Red Bull, në vlerë prej 18 euro, 10 (dhjetë)copë Coca Cola në vlerë prej 5 Euro, 12(dymbëdhjetë) copa çokolata Milka në vlerë prej 12 euro, 8(tetë) copë sallama të pulës në vlerë prej 8 euro, 9(nëntë) copë Kinder çokolata në vlerë prej 9 euro, si dhe para të gatshme në shumë prej 60 euro, e të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material në lartë prej 179 euro, e largohen në drejtim të paditur.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve A. K. dhe A. M. gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të dispozitave të

nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: gjendjen e tyre të dobët ekonomike, mosha e tyre e re në kohën e kryerjes së veprës penale, pranimin e fajit, pendimin e tyre të thellë për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprat e tilla penale, sjelljet korrekte të tyre gjatë gjykimit, inteziteti e rrezikimit, dëmtimi i vlerës së mbrojtur, në bazë të këtyre Gjykata konstaton se ekzistojnë rrethanat posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, komfor nenit 75 par.1 nën par.1.2 të KPRK-ës, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata ka marr parasysh motivin për kryerjen e veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljet e tyre para dhe pas kryerjes së veprës, pasi që të njëjtit për Gjykatën janë të njohur si recidivistë të veprave të ngjashme penale, andaj duke marr parasysh këto rrethana, Gjykata të njëjtit i gjykoji me dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqind)Euro**, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **12(Dymbëdhjetë)muajve**, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë, për secilin veç e veç, me bindje se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, Gjykata e mori në mbështetje të nenit 453 par.4 të KPPK-së, nga se detyrimi që ti paguajnë shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarve dhe personave që ata detyrohen të mbështesin materialisht.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
-Departamenti i Përgjithshëm-  
P. nr.450/17 më datë 11.12.2018**

**Sekretarja juridike,  
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjyquese  
Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:029983  
Datë: 11.12.2018  
Numri i dokumentit: 00186553